

## NË PËRKUJTIM TË KOLEGUT DHE MIKUT TË NDERUAR, PROF. FRANCESCO MACCHIA, UNIVERSITETI I BARIT, ITALI

**MIHO ALEKO**

Departamenti i Biologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës

e-mail: aleko.miho@fshn.edu.al



Në dt. 01 Nëntor 2022 mbushen 3 vite që është ndarë nga jeta Prof. Francesco Macchia, Universiteti i Barit 'Aldo Moro', koleg dhe mik i nderuar me të cilin kemi bashkëpunuar për vite me radhë. Është falë figurave si Prof. Macchia që shumë prej nesh mundën të rimëkëmben në një periudhë vërtetë të vështirë, të njohim më mirë rrugët e dijes dhe përafrimin me Europën. Më poshtë do jap disa mbresa dhe arritje që kemi pasur gjatë bashkëpunimit me Profesorin, jo vetëm për ta përkujtuar dhe si shenjë mirënjohje, por edhe si një frymëzim për të rinjtë, dhe nxitje për një rrugëtim të tillë.

Prof. Macchia u nda nga jeta në moshën 85 vjeç. Nga kolegët e tij njihej si një person i sinqertë, i qeshur, plot humor, që menjëherë krijonte një ndjenjë ngrohtësie dhe respekti tek bashkëbiseduesi. Mbi të gjitha, ishte një botanist i shkëlqyer, një nga natyralistët që e bëri Universitetin e Barit një qendër mendimi dhe kërkimi mjedisor; i tillë është edhe sot. Kopshti Botanik 'i tij', i vendosur në hapësirën e kampusit universitar, mbetet edhe sot një nga mjediset më të bukura që çdokush mund gjejë në Bari.

Falë përpjekjeve të Profesorit dhe kolegëve të tij, Universiteti i Barit ishte, midis viteve 70 dhe 80 të shekullit të kaluar, një qendër e mendimit natyralist shkencor në Itali. Në këtë mënyrë, lindën 'Simpoziumet Kombëtare për Ruajtjen e Natyrës', ku specialistë nga disiplina të ndryshme shkencore që lidhen me mjedisin natyror shpalosën njohuritë dhe idetë e tyre për mbrojtjen e natyrës. Nga ato Simpoziume dolën aktet e para apuliane për krijimin e zonave të mbrojtura, ligji rajonal për parqet natyrore të pajisura (1975), ligji rajonal për rezervat natyrore rajonale (1977), dhe shumë të dhëna për

mjediset që duhet të mbroheshin, të bashkuara në ligjin aktual rajonal për zonat e mbrojtura (1997) në Itali.

Me Profesorin jam njohur herët, në fillimet e viteve 2000, kur ai kishte nisur një bashkëpunim INTERREG me kolegët e Kopshtit Botanik, me Prof. L. Dinga, Prof. P. Hoda dhe të tjerë. Në ato vite unë me kolegë të kimisë këtu në fakultet, dhe me ata të Universitetit Bujqësor, ishim në përpjekje për një projekt kërkimor për Ujëmbledhësin e Bovillës. Prof. Macchia ndihmoi që propozimi ynë të prezantohej në një panair projektesh kërkim-zhvillimi në Shkup. Nga ky bashkëpunim dhe kjo vizitë, bashkë me delegacionin e Universitetit të Barit, unë ruaj kujtimet më të mira, jo vetëm lidhur me shkrimin dhe paraqitjen e një projekti kërkimor, por edhe atë të atmosferës tepër të ngrohtë dhe miqësore që shpesh vetëm italianët dinë ta japin; dhe veçanërisht Prof. Macchia dallohej!

Nuk patëm sukses për Bovillën në atë kohë, por kjo ishte një përvojë e vyer për ne. Pak më vonë, në vitet 2005-2008, studimi i Bovillës u mundësua falë një tjetër bashkëpunimi lapidar për ne, ai me Prof. R. Bachofen, nga Universiteti i Zyrihut (<https://fshn.edu.al/info/publikime-shkencore>).



*Majtas*, gjatë takimit të ekipit tonë drejtues të projektit Tempus me Rektorin e Universitetit të Barit; *djathtas*, Prof. Macchia dhe Prof. Appenroth, me mua në qendër dhe kolegë të tjerë botanistë në zyrën time në fakultet.

Në atë periudhë, përpjekjet tona ishin të adresuara edhe drejt përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Kërkesa kryesore e kohës ishte reformimi i programeve biologjike në përputhje me nevojat për ndryshim në Shqipëri dhe me Deklaratën e Bolonjës. Bashkë me kolegun tjetër, Prof. K. Appenroth, të Universitetit të Jenës, Gjermani, gjithashtu një Figurë tjetër e bashkëpunimeve tona në vite, hartuam një projekt të përbashkët TEMPUS, i cili pati sukses dhe u vu në zbatim në vitet 2003-2006. Objektivi kryesor ishte përshtatja e drejttimeve ekzistuese biologjike universitare dhe pasuniversitare me standardet e BE, me sistemin e krediteve (ECTS) etj. Universiteti i Jenës dhe i Barit ishin dy partnerët kryesorë, dhe Prof. Macchia

ishite personi i kontaktit për palën italiane. Kuptohet se sot shumë gjëra kanë ndryshuar për mirë në Universitetin tonë; por në atë kohë mjediset tona ishin me mungesa të theksuara, të mobiluara keq, me kushte shumë larg asaj që kërkohesh për një punë normale, si në mësim dhe në kërkim. Mblidheshim ndonjëherë në dimër rreth ndonjë reflektori, i cili na ngrohte vetëm nga njëra anë, duke punuar deri vonë për projektin. Pa folur për mënyrën jo fort të lehtë të komunikimit mes nesh në atë kohë, për të sqaruar dhe vënë në vijë shumë nga kërkesat e projektit për disa vite me radhë.

Falë kësaj mundësie, rreth 45 kolegë shkuan për vizitë të shkurtër (1 deri 4 javë) në universitetet partnere, shumica në Bari, përfshirë këtu edhe kolegë të lëndëve të përgjithshme, Matematikë, Kimi, Fizikë etj. Vizitat e 7 asistentëve të rinj (deri në tre muaj), ishin në përparësi, për të përgatitur diplomat ose doktoratat e tyre. Kjo ishte një mundësi jo e vogël për të gjithë kolegët, për t'u njohur me programet mësimore përkatëse, bazën laboratorike, praktikat, literaturën, fushat kërkimore etj. Po ashtu, rreth 15 kolegë nga universitetet partnere erdhën në Tiranë, ku zhvilluan shpesh takime pune nxitëse dhe informuese, seminare dhe leksione me studentët etj. Me specialistë vendas dhe të huaj, dhe me asistentët e rinj janë bërë disa ekspedita në vende interesante të natyrës shqiptare. Ato ishin një mundësi më shumë bashkëpunimi dhe shkëmbimi përvojë mes kolegësh, për biodiversitetin, për vlerat ekonomike dhe natyrore, për aspektet ekologjike të zonave të ndryshme etj. Kjo u krijoi mundësinë edhe shumë kolegëve të rinj të grumbullojnë material dhe të dhëna për punët e diplomave apo doktoratave.

Një nga çështjet më të rëndësishme të projektit ishte fuqizimi i laboratorëve mësimorë. Rreth 40 mikroskopë dhe 12 stereomikroskopë u shpërndanë në laboratorët kryesorë të Botanikës, Zoologjisë dhe Biologjisë.

Në secilin prej këtyre laboratorëve u vendos edhe nga një komplet mikroskopi i pajisur me kamer, i lidhur me kompjuter dhe televizor, që është risi edhe sot. Laboratorët e tjerë të Fiziologjisë Bimore, Mikrobiologjisë, Fiziologjisë Shtazore u pajisën me pajisje të tjera, si spektrofotometër, centrifugë, PCR, peshore analitike, sistemi filtrimi, dhomë pune mikrobiologjike dhe sistem pastrimi UV, frigorifer etj. Këto ndihmuan shumë në atë kohë për të përmirësuar jo vetëm mësimdhënien, por edhe punën kërkimore me studentët diplomantë dhe doktorantë. Laboratorët kryesorë dhe mjediset e punës u pajisën edhe me bateri me inverter për të mundësuar vazhdimin e punës edhe në mungesë të energjisë elektrike, në atë kohë jo e zgjidhur si duhet. Laboratorët u pajisën gjithashtu me qelqurina, mjete pune praktike, kimikate, preparate mikroskopike etj.

Një fotokopje, shtatë kompjutera, 4 bimera dhe projektorë u vunë në përdorim për Departamentin, për përgatitjen e materialeve mësimore-kërkimore dhe zhvillimin e mësimin. Ndërkohë u riparuan dhe u vendosën në punë shumë kompjutera të tjerë për studentët diplomantë. Gjithashtu, u bë e mundur lidhja e internetit për pjesën më të madhe të zyrave, dhe u pagua

edhe taksa përkatëse e shërbimit të internetit për gjithë fakultetin. U rindërtua dhe pasurua me informacion faqja e Departamentit të Biologjisë në FShN ([www.fshn.edu.al](http://www.fshn.edu.al)).

Nuk ishte pak në atë kohë shtypshkrimi i mbi 30 teksteve mësimore në shqip (gjithsej mbi 7800 faqe) të shumëfishuara nga 300 deri në 2000 kopje secili, të cilët mbuluan nevojat e studentëve për rreth 5 vjet. Në Bari ose Jena u blenë mbi 30 libra të ndryshëm, nga më të zakonshmit në përdorim për mësimdhënie në Biologji në atë kohë. Dhjetë kopje për çdo libër të shtypur në shqip, dhe të gjithë librat e huaj u dorëzuan në fondin e Bibliotekës së Fakultetit. Shumë nga tekstet e printuar apo librat e blerë janë në përdorim edhe sot.

Falë këtyre përpjekjeve kurset egzistuese të Biologji-Kimisë (4-vjeçare) dhe të Biologjisë (5-vjeçare) u reformuan në kurse biologjie bachelor (3-vjeçar) dhe master (2-vjeçar), përvojë kjo thuajse e re dhe ndër të parat në vend. Planet mësimore egzistuese dhe programet e lëndëve me fare pak ndryshime ruajnë edhe sot atë që ne mundëm të reformonim atëherë. Po ashtu një pjesë e mirë e laboratorëve tanë, ruajnë ende atë paraqitje që ne mundëm të krijojmë nën mbështetjen e projektit TEMPUS (flas sistemimin e tavolinave dhe rafteve, pajisjet, preparatet mikroskopike etj.); nuk mund të mos përmend këtu edhe kualifikimet e stafit në shkallë të gjerë, si dhe shkëmbimet e ndërsjella me Universitetin e Jenës dhe të Barit dhe gjetkë.

Në retrospektivën e mbi 15 viteve unë vlerësoj me shumë respekt këtë bashkëpunim mes nesh, përfshirë këtu edhe me gjithë stafin drejtues të Departamentit, të Fakultetit, dhe gjithë kolegët e tjerë të asaj kohe. E quaj tepër të çmuar dakordësinë për të bërë më të mirën e mundshme për reformën, për të gjitha aktivitetet, për të mos ngadalësuar apo penguar ecurinë e saj, dhe të vetë projektit. Shumë mirënjohje me këtë rast edhe ndaj shumë kolegëve në Universitetin e Barit dhe të Jenës që pritën dhe mbështetën homologët e tyre nga Tirana. Falë kësaj atmosfere bashkëpunimi mes nesh, projekti TEMPUS i asaj kohe u vlerësua ndër më të mirët në Bruksel.

Kuptohet se gjithë këto arritje të asaj kohe u bënë me diskutime të shumta mes nesh si drejtues kryesorë, me shumë përpjekje për të bërë më të mirën e mundshme, dhe gjithmonë kjo në një atmosferë mirëkuptimi do thosha të shkëlqyer. Në takimet tona trishe, mes një shqiptari, një italiani dhe një gjermani, me gjuhët tona përkatëse jo gjithmonë sqarimet ishin bindëse. Por kur ishte dëshira e mirë, gjithshka përfundonte në dakordësi, ku nuk mungonte edhe humori i Profesorit, i cili përmbyllte ëmbël gjithshka.

Prof. Macchia kujtohet me respekt nga shumë prej nesh sidomos për pritjet e bëra të gjithsecilit prej nesh gjatë vizitës në Itali, nga mbrritja në portin e Barit, sistemimi në hotel, shoqërimi nëpër vizitat në Universitet, e daljet e tjera në shumë vende historike të zonës së Pulias. Shumë nga studentët e asaj kohe kujtojnë leksionet e hapura të zhvilluara prej tij në Tiranë, ku dallohej oratoria dhe humori tërheqës në shumë çështje botanike, edhe kur ato ishin

tepër të thelluara. Pa dyshim daljet tona të përbashkëta në Alpet shqiptare kanë qënë qershia mbi tortë në gjithë këtë bashkëpunim, nga panorama dhe biodiversiteti i luginave të Cemit, Thethit dhe Valbonës, e deri te mikpritja në Lëpushë, në Theth dhe në Bajram Curri.



*Majtas*, me kolegë italianë, gjermanë dhe shqiptarë në traqetin e Komanit, gjatë vizitës sonë në Alpet shqiptare, në qershor 2005; *djathtas*, mbi tunelin e marrjes së ujit të pijshëm në Ujëmbledhësin e Bovillës, bashkë dhe me Prof. Appenroth, nga Universiteti i Jenës dhe Prof. Bachofen nga Universiteti i Zyrihut.

Edhe pas mbylljes së projektit TEMPUS kontaktet me Prof. Macchia nuk reshtën. Edhe pse në moshë të thyer Ai ishte i pranishëm në gjithë punët, përpjekjet tona, përfshirë dhe hallet e gëzimet familjare të gjithësecilit prej nesh. Në këtë përvjetor të humbjes së tij unë dhe kolegët e mi përulemi me shumë respekt ndaj Tij! Faleminderit Prof. Macchia! Me këtë rast i shprehim edhe një herë ngushëllimet tona më të sinqerta gjithë familjes, shokëve dhe miqve. U prehtë në paqe dhe qoftë gjithmonë i paharruar!